

Бр.-Nr. 03 -1740/1
03 -04 - 2020 20 год-вти
СКОПЈЕ - SHKUP



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

RECORDED IN OSCE ARCHIVE	
OSCE Mission to Skopje	
Date:	31 MARCH 2020
4.3.2.	HD
Reg. No.	051/2020 translation



MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

NDËRMJET

ORGANIZATËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

MISIONI NË SHKUP

DHE

KOMISIONIT SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

PËR IMPLEMENTIMIN E AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA NË PERIUDHËN

2020-2022

Ky Memorandum për bashkëpunim (më tej në tekst si "memorandumi") nënshkruhet ndërmjet Organizatës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (më tej në tekst si "OSBE"), nëpërmjet Misionit në Shkup (më tej në tekst si "Misioni"), me adresë Ndërtesa Hiperium, Bul. 8 shtatori, nr. 16, MK-1000 Shkup,

dhe

Komisionit shtetëror për parandalimin e korruptionit (më tej në tekst si "KSHPK") me adresë rr. „Dame Gruev”, nr. 1, 1000 Shkup.

Më tej në tekst, Misioni dhe KSHPK emrohen individualisht si "Pala", dhe së bashku si – "Palët",

DUKE MARR PARASYESH se Misioni ka mandat për të ndihmuar përpjekjet e shtetit në drejtim të reformimit të administratës publike dhe demokratizimin e shoqërisë përmes promovimit të parimeve të menaxhimit demokratik dhe luftën kundër korruptionit në përputhshmëri me zotimet e OSBE-së, standartet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira; dhe

DUKE MARR PARASYSHË se KSHPK është i përkushtuar në zbatimin e ligjeve, përforcimin normativ dhe institucional, krijimin e politikave dhe masave antikorruptive, promovimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe zhvillimin e kulturës së të drejtës për etablimin e një sistemi efektiv për parandalim dhe represion të korruptionit dhe konfliktit të interesave.

Palët u dakorduan për të ardhshmen:

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi i memorandumit

Ky memprandum siguron kornizë për bashkëpunim ndërmjet Palëve për qëllimet e zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta të cilat synojnë avancimin e praktikave për parandalimin e korruptionit dhe përforcimin e sistemit të integritetit. Aktivitetet e përbashkëta fillimisht do të përputhen me parimet e përcaktuara nga Ligji për parandalimin e korruptionit dhe konfliktit të interesave, Strategjinë kombëtare për parandalimin e korruptionit dhe konfliktit të interesave 2020-2024 të miratuar nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korruptionit, dokumente të tjera strategjike, si dhe aktivitete tjera të cilat do të dokordohen mes palëve. Aktivitetet e përbashkëta, përfshirë edhe afatet dhe detajet tjera lidhur me realizimin e tyre do të përpikësohen kur do të përvijohet bashkë Plani vjetor i aktiviteteve, i cili do të miratohet nga palët përmes kontakt personave të evidentuar më poshtë.

Neni 2

Përgjegjësitet e Misionit

Në pajtim me nenet e këtij memorandumi, Misioni:

1. Do t'i sigurojë përkrahje strategjike KSHPK në përpjekjet e tij për zbatimin e aktiviteteve nga sfera e parandalimit të korruptionit dhe përforcimit të integritetit personal dhe institucional në pajtim me standardet kombëtare, zotimet e OSBE-së dhe standardeve ndërkombëtare;
2. Do të koordinojë dhe bashkëpunojë me KSHPK, si dhe me palët e tjera të interesit për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta;
3. Do ta financojë zbatimin e përbashkët të aktiviteteve dhe do të jetë vetë përgjegjës për përdorimin dhe shpenzimin e mjeteve të veta financiare, në pajtim me rregullat dhe rregulloret e veta;

- Do të kryej detyra tjera të përvijuara në Planin vjetor të aktiviteteve.

Neni 3

Përgjegjësitë e KSHPK

Në pajtim me nenet e këtij memorandumi, KSHPK:

- Do të bashkëpunojë me Misionin dhe do ta promovojë zbatimin e legjislacionit kombëtar, zotimet ndërkombe të standardeve OSBE-së në fushën e luftës kundër korruptionit;
- Do t'i ndërmarrë të gjitha masat për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta, duke përfshirë edhe informimin në kohë dhe preciz të Misionit përvështirësitë eventuale të cilat mund të paraqiten gjatë zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta;
- Do të komunikojë me organet relevante të pushtetit, si dhe palët tjera të interesit, me qëllim zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta;
- Do të veprojë në pajtim me legjislacionin relevant dhe në kohë do t'i sigurojë lejet e nevojshme/pajtimet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta;
- Do të kryej detyra tjera të përvijuara në Planin vjetor të aktiviteteve.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe dëmshpërblimi

- OSBE-ja nuk ndërmerr përgjegjësi apo detyrim për mbulim të pretendimeve përborxhe, dëme, kërkesa apo humbje si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të qëllimshme që i atribuohen drejtpërdrejt KSHPK ose palës së tretë gjatë zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta.
- Palët do të sigurojnë që zyrtarët e tyre, agjentët dhe personat që kryejnë shërbime për Palët dhe çdo person tjetër nën mbikëqyrjen e Palëve me qëllim të zbatimit të

aktiviteteve të përbashkëta, do të shmangin çdo veprim që mund të reflektojë negativisht mbi imazhin dhe statusin e palëve.

Neni 5

Publicitet

Aty ku është e përshtatshme, KSHPK do të falënderon OSBE-në në publikime, fjalime, dhe deklaratat për media apo media tjera të ngjashme.

Neni 6

Pronësia intelektuale

1. Gjitha të drejtat, pronësitë dhe interesat, dhe pa kufizime përfshirë të drejtat autoriale apo patentat për ndonjë material të prodhuar apo zbulim të bërë në suaza të zbatimit të këtij memorandumi ngelin ekskluzivisht mbi OSBE-në. KSHPK mund të përdorë materialet e përpiluara, zbuluara apo zhvilluara gjatë aktiviteteve të përbashkëta në mënyrë kompatibile me dhe siç është parashikuar nga aktivitetet e përbashkëta.
2. KSHPK mund të përdorë emrin dhe logon e OSBE-së ose të Misionit vetëm në lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e përbashkëta, dhe pëlqim paraprakë me shkrim të Misionit.
3. OSBE-ja mund t'i redaktojë materialet e shtypura, elektronike ose resurset e tjera të përpiluara gjatë zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe të njëjtat ti vendosë në linjë me stilin intern të OSBE-së, riprodhimin, identitetin vizual dhe standardeve gjuhësore, politikave dhe kërkesave të veta.

Neni 7

Mos-përfitimi i zyrtarëve

Palët nuk do t'i mundësojnë asnjë zyrtari të Palës tjeter ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë ose indirekt ose trajtim preferencial në bazë të këtij memorandum. Çdo shkelje e kësaj dispozite përbën shkelje thelbësore të këtij memorandumi.

Neni 8

Komunikimi

Të gjitha komunikimet që kanë të bëjnë me implementimin e [Projekti/aktivitetet e përbashkëta] do të adresohen përmes kontakt personave të ardhshëm:

Për Misionin:

KSHPK:

Përgjegjëse për portfolion: Maja Lazarova

Projekt menaxher: Maja Konevska

Adresa: Ndërtesa Hyperium,
bul. 8 shtatori nr. 16,
MK-1000, Shkup

Adresa: rr. "Dame Gruev" nr. 1,
1000, Shkup

Telefon: +389 70 383374

Celulari: +389 70 342 774

Faks: +389 2 3234 564

Telefaksi: +389 2 3215 380

E-mail: Maja.Lazarova@osce.org

E-mail: mkonevska@dksk.org.mk
contact@dksk.org.mk

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të bëjnë përpjekje që në mënyrë paqësore t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga ky memorandum, janë në lidhje me të njëtin ose rezultojnë nga interpretimi i të njëjtës. Gjitha dallimet, polemikat apo pretendimet që mund të dalin gjatë aplikimit të dispozitave të memorandumit do të zgjidhen përmes negociatave miqësore mes Palëve. Në rast se Palët dështojnë në zgjidhjen miqësore të dallimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i negociatave, dallimet do të zgjidhen nëpërmjet arbitrimit. Arbitrimi do të bëhet në përputhje me UNCITRAL rregullat arbitrale. Do të caktohet një (1) arbitrues i vetëm i cili do të gjëzojë fuqitë e plota për të ndërmarrë vendime finale dhe obliguese. Gjyqi Permanent Arbitral i Hagës do të jetë autoriteti i përcaktimit. Vendi i arbitrimit do të jetë Vjena dhe gjuha që do të përdoret gjatë arbitrimit do të jetë gjuha angleze.

Neni 10

Privilegjet dhe Imuniteti

Asgjë që përmban ky memorandum ose është në lidhje me të njëtin nuk mund të konsiderohet si heqje dore e privilegjeve apo imunitetit që gjëzon OSBE.

Neni 11

Ndryshimet

1. Çdo ndryshim i këtij memorandumi duhet të bëhet me miratim me shkrim ndërmjet Palëve.
2. Ky memorandum zëvendëson çfarëdo dhe të gjitha deklaratat paraprake të shkruara apo gojore, marrëveshjet dhe përfaqësimet e palëve lidhur me aktivitetet e përbashkëta.

Neni 12

Përfundimi

1. Në rast se Pala beson se ky memorandum nuk mund më të zbatohet në mënyrë efikase apo të përshtatshme, do ta konsultojë Palët tjetër sa më shpejtë. Në rast se nuk arrihet konsensus mbi një zgjidhjeje adekuate, i njëjt mund të përfundohet më herët nga cilado Palë, duke dhënë paralajmërim me shkrim prej jo më pak se tridhjetë (30) ditëve kalendarike. Në atë rast, data e përfundimit do t'i përshtatet për të lejuar mbarim të rregullt të operacioneve lidhur me implementimin e aktiviteteve të përbashkëta.
2. Misioni mund ta përfundojë këtë memorandum menjëherë në tërësi në rast të kufizimeve në buxhet ose ndryshim mandati të Misionit.

Neni 13

Tërësia e memorandumit

Anekset e përmendura në Nenin 1 janë pjesë përbërëse e këtij memorandumi. Nëse ka mospjtim ose konflikt mes neneve të memorandumit dhe anekseve, do të mbisundojnë dispozitat të cilat gjenden tek memorandumi.

Neni 14

Validiteti i vazhduar

Dispozitat të cilat gjinden në nenin 4 (Përgjegjësitë dhe dëmshpérblimi), nenin 6 (Pronësia intelektuale), nenin 9 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) dhe nenin 10 (Privilegjet dhe imunitetet) do të zbatohen edhe pas terminimit, gjegjësisht skadimit të afatit të këtij memorandumi.

Neni 15


Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Ky memorandum hyn në fuqi prej momentit të nënshkrimit nga Palët dhe vlen deri në 31 dhjetor 2022 përveç nëse cilado nga Palët vendosë ta përfundojë atë më herët duke dhënë paralajmërim me shkrim në përputhshmëri me Nenin 12 të këtij memorandumi.

Fuqia ligjore e këtij memorandumi do të llogaritet si e vazduar në bazë vjetore nëse palët vazhdojnë të krijojnë plan për aktivitete vjetore edhe pas 2022.

Ky memorandum është përpiluar në dy (2) ekzemplarë origjinal në gjuhën angleze dhe dy (2) ekzemplarë në gjuhën maqedonase, nga një kopje prej çdo gjuhe për të dyja palët nga një (1) për çdo Palë.

Përkthimi i këtij memorandumi në gjuhën maqedonase dhe shqipe do të shërbejë vetëm për qëllime informative dhe në rast të mospajtimit lidhur me interpretimin e dispozitave, versioni në gjuhën angleze konsiderohet si origjinal.



Për OSBE-në

KSHPK

Ambasadori Klemens Koja,

Biljana Ivanovska

Shef i Misionit

Kryetare

Data:

30/3/2020

Data:

03.04.2020



